



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.19/2018

Prishtinë, më 25 prill 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Saranda Bogujevci, Frashër Krasniqi, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Albulena Balaj Halimaj.

Munguan: Mirjeta Kalludra dhe Teuta Haxhiu.

Pjesëmarrës të tjerë: Teuta Prekazi-UN Human Rights, Besjan Bajrami-Ekonomia Online, Tafil Rrahmani IAP, Majlinda Sinani Lulaj-IAP, Fatjona Gegaj-Fakulteti Juridik UP, Faik Sylaj-Fakulteti Juridik UP, Edmond Nikolla Fakulteti Juridik UP, Visar Bivolaku-EUO/EUSR, Adelina Kajtazi-ABGJ /ZKM, Leonora Selmani-ABGJ/ZKM, Naim Qelaj-Koordinator Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Adile Shaqiri-MPMS, Florentina Beqiraj-MD, Erita Thaqi-Fakulteti Juridik dhe Agnesa Sinani-MD.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare dhe Lirije Kajtazi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i Raportit vjetor 2017 të Institucionit të Avokatit të Popullit;
2. Raportimi në Komision lidhur me zbatimin e Strategjisë kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe plani i veprimtimit 2016-2020, funksionimin e strehimoreve dhe luftimin e dhunës në familje.

Të ftuar: Koordinatori Nacional kundër dhunës në familje, kryeshefja ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore dhe përfaqësues nga Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes – MPMS,

3. Njoftim i Komisionit Funkcional lidhur me shqyrtimin e Peticioneve nga Grupi Punues;

4. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Raportit vjetor 2017 të Institucionit të Avokatit të Popullit

Kryetarja tha se për këtë pikë të rendit të ditës është i pranishëm Avokati i Popullit, i cili do ta paraqes Raportit.

Hilmi Jashari: Raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit, e kemi dorëzuar sipas afatit kohor të paraparë me Ligjin për Avokatin e Popullit.

Ky raport përfshin një përshkrim të gjithë situatës brenda vitit 2017, sa i përket gjendjes së të drejtave të njeriut dhe përmbledhjen e të gjitha raporteve dhe rekomandimeve që janë dorëzuar autoriteteve publike të Kosovës.

Raporti është ndarë në tri pjesë të cilat janë vlerësuar si çështje me interes të veçantë. Pjesa e parë i referohet funksionimit të sistemit ligjor në Kosovë, që konsiderojmë si njërën prej pikave të dobëta në të gjithë sistemin, ku kemi analizuar pse kemi një situatë të tillë dhe çka duhet bërë që një situatë e tillë të përmirësohet.

Në pjesën dytë janë trajtuar problemet që afektojnë në funksionimin e sistemit gjyqësor në Kosovë dhe gjithashtu duke numëruar problemet sistematike të cilat i kemi vërejtur gjatë punës.

Në pjesën e tretë përfshihet funksionimi i administratës publike ose ekzekutivit.

Pjesa tjetër e raportit trajton në mënyrë të përmbledhur të gjitha raportet që janë trajtuar gjatë këtij viti dhe si pjesë e veçante është edhe raporti financiar i Institucionit të Avokatit të Popullit të cilin e kemi raportuar para Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit.

Gjate këtyre tri viteve kam vërejtur se i gjithë legjisllacioni që dorëzohet për miratim në Kuvend, në fakt është legjisllacion me ndryshime dhe plotësime eventualisht nga viti paraprak. Në vitin 2017 janë miratuar 21 ligje dhe prej këtyre 50% kanë qenë ligje për plotësim ndryshime, dhe kjo ndikon fuqishëm në dëmtimin komplet të sistemit juridik, sepse nuk ekziston një siguri juridike, as te administratorët që duhet zbatuar një ligj të tillë, e as te gjykatat dhe gjyqtarët që duhet vendosur çështjet që ju drejtohen për trajtim.

Procesi i miratimit të ligjeve vazhdon me qenë një problem sistematik i kundërthënies të mëdha të dispozitave të ligjeve të ndryshme mes vete, por edhe brenda një ligji.

Sa i përket funksionimit të sistemit gjyqësor, edhe gjatë vitit 2017 ka pasur shumë probleme në vendime brenda një afati të arsyeshëm kohor. Problem tjetër është se asnjë qytetarë nuk arrin me marrë kompensim nga shteti në rast se ati i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Çështje tjetër është edhe mosekzekutimi i vendimeve të plotfuqishme të gjyqësorit, i cili nuk ka pësuar asnjë ndryshim nga dy vitet paraprake. Është një numër jashtëzakonisht i madh që janë vendosë nga gjykata, mirëpo, fatkeqësisht vazhdojnë të mos zbatohen.

Sa i përket ekzekutivit, duke përfshi dy nivelet vazhdon të karakterizohet me papërgjegjshmërinë e plotë. Kjo administratë do duhej të mbikëqyrej nga një gjykatë efektive e

cila do duhej të ishte Gjykata për Konfliktet Administrative në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Kryetarja, tha se na vjen mirë që në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën, puna e IAP-it është vlerësuar lartë.

Lirije Kajtazi, tha se i keni rekomanduar institucioneve njohjen e përvojës së punës për vitet e paraluftës, ngase është shumë esenciale që të njihet kjo përvojë, që nga politikat diskriminuese këta njerëz janë larguar nga puna.

Ajo tha se kemi pasur raste që na u kanë adresuar për çështjen e kujdesit ndaj të rinjve në pjesën spitalore të rehabilitimit me urdhër të gjykatës. Ka persona që janë në pritje me vite të tëra, çka mund të bëjmë më tepër për t'i ngritur kapacitetet për të tejkaluar këtë problem.

Ndërsa sa i përket ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve, pyeti se a e sheh këtë si nevojë të brendshme apo për plotësim kriteresh.

Miljana Nikoliq, Grupi Parlamentar Lista Serbe ka shqyrtuar Raportin e Avokatit të Popullit i cili është i detajuar për të gjitha bashkësitë në këtë vend, por nuk merret në mënyrë të detajuar me problemet e bashkësisë serbe, e cila ballafaqohet me probleme të mëdha.

Hapësirë e madhe iu është dhënë bashkësive të tjera, gjë që e përkrahim.

E ftojme Avokatin e Popullit që në përputhje me kompetencat që ka, të mirret me garancitë kushtetuese që i kanë serbët, të cilat rregullisht po shkelën. Në dokumentet personale serbët nuk kanë të drejtë në nacionalitetin e tyre, sepse janë të detyruar të jenë kosovarë, me çka atyre u shkelet direkt e drejta kushtetuese, tha ajo. Në gjykata e drejta e përdorimit të gjuhës rregullisht ju shkelet, posaçërisht e drejta që procesverbalet ti marrin në gjuhën serbe. Serbëve nuk u mundësohet që institucioneve të iu drejtohen në shkresat e tyre, në çirilicë, edhe pse bëhet fjalë për një të drejtë të detyrueshme. E drejta e përfaqësimit në institucione zbatohet deri diku, askund në tërësi. Garancionet e mëdha që u janë premtuar serbëve mbeten çdo ditë shkronjë e vdekur në letër.

Sa i përket kthimit të serbëve, theksi në mënyrë të padrejtë është drejtuar në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, si përgjegjëse për kthim të ngadalshëm.

Pastaj, Avokati i Popullit askund nuk ka përmendur problemet e shumta me të cilat ballafaqohen serbet e kthyer. Mos puna e policisë së Kosovës në ndriçimin e rasteve të vjedhjeve ndaj gjërave të serbëve, janë faktor refuzues për kthimin e serbëve. Burgosja e serbëve është porosi e qartë se ata nuk janë të mirëseardhur dhe se të gjithë mund të jenë në aktakuza të fshehta. Avokati i Popullit nuk e vëren çështjen e kthimit të dobët të serbëve në pronën e uzurpuar të tyre. Raporti i Avokatit të Popullit nuk është marrë me strategjinë nacionale të Kosovës, siç tha ajo, diskriminuese, për çështjen e pronave, (veçmas për statusin e pasurisë së serbëve të shpërngulur).

Për Avokatin e Popullit nuk shihet numri i shkeljeve të drejtave të besimtarëve të krishterë, pjesëtarë të kishës ortodokse serbe. Fokusi i tërësishtë është në Projektligjin për lirinë fetare, miratimi i të cilit është në pikëpyetje. Avokati i Popullit nuk njeh shkurtimin e të drejtës së besimtarëve serbë për të vizituar varrezat, kishat, gjuajtjen e autobusëve (të cilët bartin serbë) .

Në raport nuk flitet mbi ndodhitë në Prishtinë ku institucionet e Kosovës shfrytëzojnë pasurinë e kishës ortodokse serbe për 18 vite. Avokati i Popullit do të duhej në raport të merrej edhe me pasurinë e manastirit të Deçanit .

Në raport faturimi i energjisë elektrike për pjesën veriore është bazuar në të dhëna të pavërteta, tha ajo. Komunitat në veri të Kosovës nuk furnizohen me rrymë nga KEDS-i, dhe nuk janë të obliguar ti paguajnë KEDS-it. Kjo është çështje e bisedimeve të Brukselit.

Raporti me rekomandime lidhur me Agjencinë për klasifikim dhe verifikim të pronës, është hap pozitiv por jo i mjaftueshëm që Lista Serbe të votojë për Raportin vjetor të Avokatit të Popullit.

Kryetarja, tha se sipas informatës që ka sjellë ZRRE-ja, veriu i Kosovës e ka shfrytëzuar rrymën e Kosovës.

Nuk e kemi numëruar se sa rreshta në Raportin e IAP-it, i janë lënë komunitetit serb, sa romëve, ashkalive, exhiptasve e të tjerëve.

Por, në parim, nuk besoj se dikush ka të drejtë të thotë se kjo nuk është reale. Ajo tha se ekziston Ministria për Kthim dhe kanë shumë buxhet dhe nëse ky buxhet nuk është shfrytëzuar nga serbët atëherë nga kush është shpenzuar?

Më tej, theksoi se është e sigurt se të tjerët asnjë cent nuk e kanë marr nga ana e kësaj ministrie, e di çfarë probleme sociale kanë komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian, dhe pyeti se sa ankesa ka pasur nga komuniteti serb në IAP në vitin 2017?

Lirije Kajtazi, tha se kush e ka lexuar Raportin përkatës sa i përket faturimit rrymës në katër komunitet veriore të Republikës së Kosovës, thuhet se kemi bërë një diskriminim zonal duke e pa që diskriminim ka edhe ne zona të tjera dhe e specifikon edhe komunitetin serb.

Atë që lexoi kolegja nga lista serbe është një pamflet i ardhur nga Beogradi, dhe tani po i kuptojë ankesat e qytetarëve serbë në veri të cilët thonë se listat zgjedhore kanë qenë komplet të falsifikuara pikërisht për të ardhur ky zë këtu.

Nuk është e rastit vjedhja e materialit kadastral nga Serbia për ta luajtur lojën me çështjen e pronave, vazhdon loja e Serbisë me të pagjeturit, ku për qëllime politike herë sjellën disa gjymtyrë e herë gjymtyrë të tjera, ndërsa në momente të caktuara, thonë se ka pengesa në ushtrimin e të drejtës fetare.

Madje, tha ajo edhe Presidentit të shtetit të Kosovës i duhet me marrë leje për të vizituar një kishë, që politika dhe koha e ka bërë ortodokse serbe, është kishë ortodokse por jo serbe dhe se daton në një kohë tjetër. Të lexohet historia drejt dhe aty të tregohen të gjitha dhe shumë çështje të tjera që ju njëherë e përgjithmonë duhet ti kuptoni nëse donit të jetoni si duhet.

Shteti i Kosovës ka ofruar mundësinë që ketë komunitet me e trajtua si pjesë përbërëse të këtij vendi, dhe si të mirat edhe të këqijat me i nda së bashku. Kush dëshiron të vazhdojë në këtë formë, jemi shumë bashkëpunues, kush donë me pa realitetin e vërtetë, por jo me fjalime të shkruara prej Beogradit.

Frashër Krasniqi, tha se Lista Serbe duhet me u përcaktua nëse me të vërtetë ju intereson integrimi i serbëve në shoqërinë e Kosovës, e nëse nuk ju intereson nuk kanë kuptim as ankesat ndaj institucioneve dhe shtetit nëse synimi është mosintegrimi.

Është e pakuptimtë se si Lista Serbe ka një lloj reagimi të madh vetëm kur ka të bëjë me çështjet e serbëve.

Krasniqi, tha se me shkeljen e të drejtave të njeriut, duhet parë se çka ndodh me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, por çka ndodhë edhe me shqiptarët.

Ai tha se puna e IAP-it, dhe në përgjithësi e Institucioneve të Kosovës nuk duhet të etnizohet, dhe IAP-i po e dëshmon një gjë të tillë dhe kjo është për tu vlerësuar.

Miljana Nikoliq, z. Krasniqi shihet në mënyrë të qartë se nuk e keni kuptuar atë çka kam thënë. E keni vërejtur se raportin e kam lexuar për shkak që në mënyrë të bindshme do të shënohet në procesverbal. Kur kam theksuar Raportin e Avokatit të Popullit i cili merret me

problematikën e shqiptarëve në veri të Kosovës, gjithashtu kam theksuar se do të duhej në mënyrë të hollësishme të merret si edhe me problemin e romëve, ashkalijve, egjiptianëve dhe të gjitha bashkësive pakicë në Kosovë. Por gjithashtu duhet të merret edhe me problemet e shumta me të cilat ballafaqohet komuniteti serb, ndërsa unë jam përfaqësuese e komuniteti serb. Ky komision do të duhej t'i dënonte shpullat e policisë të cilat i kemi pësuar më 26.3.2018, por i njëjti lidhur me këtë nuk është deklaruar. Kam votuar kundër Raportit të Avokatit të Popullit për vitin 2017.

Albulena Balaj, duke u ndërlidhur me parafolësen, tha se sa i përket procesverbalit asnjëherë nuk votohet pa u bërë pyetje se a keni vërejtje, ne jemi ata të cilët nëse kemi diçka e ndryshojmë apo e plotësojmë së bashku me administratën e Komisionit. Andaj, arsyeja e procesverbalit nuk ekziston. Sa i përket asaj që u tha nga kolegja për uzurpimin e pronave nga shqiptarët kjo është e rëndë, besoj se asnjë qytetarë i Kosovës nuk i ka uzurpuar pronë një qytetari serb, përkundrazi jemi dëshmitarë të asaj që qytetarët serbë ju kanë shitur shqiptarëve nga 5 apo 6 herë pronën e njëjtë.

Ajo më tej shtroi çështjen lidhur me harmonizimin e ligjeve, dhe se duhet ta kemi një Institucion i cili merret ekskluzivisht me harmonizimin e ligjeve të Republikës së Kosovës, kjo është shumë e rëndësishme dha ka shumë ligje të cilat janë kundërthënës, dhe në bashkëpunim edhe me ju këtë çështje do ta ngrijs edhe në seancë parlamentare.

Në vazhdim kryesimin e mbledhjes e udhëhoqi Lirije Kajtazi , nënkryetare e Komisionit.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se në këtë raport janë paraqitur çështjet reale, për disa rekomandime të bëra nga IAP-i, kemi diskutuar edhe si Komision por edhe në Kuvend. Ajo tha se i intereson të dijë se në këtë vit a ka ankesa më shumë se në vitet e tjera apo është minimizuar numri i ankesave të qytetarëve adresua IAP-i.

Mjaku-Topalli tha se draft rregullorja e Kuvendit ka kaluar leximin e parë në Kuvend dhe rekomandimi i bërë nga IAP-i është përfshirë që raporti i Avokatit vetëm të debatohet por jo të votohet.

Sa i përket raportit për faturimin e energjisë elektrike për katër komunat në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, që e kemi diskutuar edhe në Kuvend, më intereson të dije a keni marr përgjigjeje nga gjykata apo ka mbet ende aty ku ka qenë kjo çështje.

Saranda Bogujevci, tha se e vlerëson lart punën e bërë të Avokatin e Popullit.

Përndryshe, tha se ishte në lëvizje nga mbledhja e komisionit dhe sapo ka marr lajmin se personi që ishte dënuar për vrasjen e anëtareve të familjes së saj nga gjykata në Serbi është

liruar nga burgu tri vite e gjysmë më herët, ndërsa theksoi se ky lajm ishte një moment i rënd për të dhe se ndihet e shqetësuar.

Hilmi Jashari, tha se sa i përket njohjes së përvojës së punës, para ca kohësh kanë publikuar një raport në të cilin kanë trajtuar diskriminimin që u bëhet qytetarëve të vendit mbi këtë bazë dhe mbi bazën e këtij ligji, ngase pensioni kontributpagues sipas interpretimit tonë dhe sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Strasburgut konsiderohet e drejtë e pronës. Sugjerimet tona kanë qenë, ose të zvogëlohet ky afat kohor, apo e dyta që t'iu ofrohet mundësia e blerjes së përvojës së punës sikur ekziston në disa shtete të tjera.

Sa i përket mekanizmit për mbrojtje kundër torturës, për rehabilitimin e të rinjve, tha se raportet janë publike dhe sugjerimet kanë dalë për masa preventive, si dhe me rekomandime për Ministrinë e Arsimit.

Ai tha se në raport është një përshkrim shumë i gjer që i bie në kundërshtim me atë që tha deputetja Miljana Nikoliq.

IAP-i është vlerësuar si institucioni më i besueshëm në Kosove, vitin e kaluar ju kam bërë një kërkesë që të vini në Institucionin e Avokatit të Popullit nëse keni çfarëdo shqetësimi dhe do të ishim në gjendje me ju dëgjuar dhe për të parë se cilat janë ato probleme që ju i konsideroni se duhet të shqyrtohen.

Në lidhje me çështjen e faturave të rrymës, nëse e keni lexuar raportin e IAP-it, nuk bëhet fjalë në asnjë mënyrë për diskriminim etnik. Mënyra më e mirë për të rregulluar problemin e kthimit është që kjo çështje të rregullohet me ligj. Po ashtu ai tha se ju kisha lutur që ju si deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës ta sillni një rast në IAP, dhe më jepni mundësinë që të kryej punën time dhe pastaj nxirreni vlerësimet çfarëdo që ju konsideroni të përshtatshme.

Nëse nuk keni raste të tilla mos paragjykoni sepse më shumë po i kontribuoni ndasive, me vlerësime që nuk janë të qëndrueshme.

Sa i përket numrit të ankesave nga komuniteti serb është 8% në total, janë në fakt 14% që ne i kemi hap, këto janë të evidentuara në raport, të gjitha këto probleme sistematike që i përmenda afektojnë edhe qytetarin serb.

Sa i përket zbatimit të rekomandimeve të IAP-it, kemi një ngritje të zbatimit por nuk është i mjaftueshëm.

Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur që të ushtrojë si duhet pushtetin mbikëqyrës, vitin e kaluar kemi bërë një krahasim mes ushtrimit të pushtetit legjislativ dhe mbikëqyrës dhe rezultatet kanë qenë befasuese, sepse nxjerrja e ligjeve pasohet me 94%, ndërsa mbikëqyrja parlamentare është në nivelin 6%.

Ai tha se një shqetësim shumë i madh që e mundon rininë kosovare është përdorimi i drogës, sepse, shqetësuese është se nga mosha 23 vjeçare sa ka qenë mesatarja e përdoruesve të drogës brenda dy viteve tani ka rënë në moshën 16 vjeçare.

Sa i përket fabrikës së tubave, Gjykata Kushtetuese ka dhënë fjalën përfundimtare dhe në këto raste IAP-i, nuk mund të ndërhyjë sepse është vendim i plotfuqishëm gjyqësor.

Luljeta Veselaj-Gutaj, pyeti se rekomandimet që i keni plasuar tek Institucionet përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës, sa kanë gjetur zbatim.

Hilmi Jashari, tha se nëse flitet në përqindje flitet për 40-46% të rekomandimeve që kanë gjetur zbatim.

Lirije Kajtazi, në fund, hodhi në votim Raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017.

Me 5 vota për, 1 kundër dhe asnjë abstenim, zëvendëskryetarja konstatoi se Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Kuvendi të miratojë Raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017.

2. Raportimi në Komision lidhur me zbatimin e Strategjisë kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe plani i veprimit 2016-2020, për funksionimin e strehimoreve dhe luftimin e dhunës në familje. Të ftuar: Koordinatori nacional kundër dhunës në familje, kryeshefja ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore dhe përfaqësues nga Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes – MPMS-ja

Lirije Kajtazi, për raportimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje tha se kemi të pranishëm koordinatorin nacional, t cilit ia dha fjalën në vazhdim.

Naim Qelaj, tha se sfidë kryesore që kanë në zbatimin e kësaj strategjie është koordinimi. Kamë menduar që raportimi i rregullt i grupit ndërministror, ku gjithë ministritë dhe agjencitë që janë pjesë e grupit, të raportojnë në baza dy apo tremujore në zyrën e koordinatorit.

Së shpejti do të realizohet krijimi i një baze të vetme të të dhënave për rastet nga dhuna në familje që është kërkesë e kamotshme. Një rol të rëndësishëm në zbatimin e kësaj strategjie e kanë edhe komunat.

Shtyllat e strategjisë janë parandalimi, vetëdijesimi, mbrojtja dhe koordinimi, sa i përket parandalimit dhe vetëdijesimit janë mbajtur fushata vetëdijësuese nëpër shkolla dhe institucione.

Është bërë një fushatë tek opinionin publik për ti gjykuar rastet e dhunës në familje, në një formë mos me u gjykua vet viktimat por, me u gjykua kryerësi. Në bazë të strategjisë parashikohet që në shkollat të jetë një numër shtesë prej 80 pedagogëve dhe psikologëve, për të cilën gjë deri sot nuk kemi pasur ndonjë lëvizje pozitive.

Ai tha se ka biseduar me Ministrinë e Arsimit dhe do të insistoj prapë që kjo të ndodhë, për arsye se në shumicën dërmuese të shkollave mungon ky kuadër profesional i cili është shumë i rëndësishëm.

Sa i përket mbrojtjes dhe koordinimit nëpër të gjitha gjykata dhe prokuroritë ekzistojnë njësitë e veçanta për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, sa i përket legjislacionit, hetimit dhe procedimit Kosova është duke bërë një hap shumë të madh me ndryshimin e Kodit Penal, për arsye se për herë të parë tek ne, parashihet dhuna në familje si vepër e veçantë penale.

Sa i përket rehabilitimit dhe riintegritimit është pjesa më sfiduese, sepse ka një kosto të madhe financiare.

Më pas, ai tha se strategjia është një dokument shumë i mirë, është i zbatueshëm dhe në një të ardhme do të mundohemi për ta zbërthyer në module, në mënyrë secila agjenci dhe secila ministri me pas vetëm pjesën e vetë të detyrave, të cilat duhet realizuar dhe pastaj kjo do të ndikojë që edhe Zyra e Koordinatorit me pas më të lehtë mbikëqyrjen e zbatimit të strategjisë.

Mexhide Mjaku-Topalli, u interesua të dijë se në cilat ministri keni hasur se ka ngecje në zbatimin e strategjisë.

Sa i përket çështjes së strehimoreve kjo ka qenë problem edhe mandatin e kaluar, çfarë keni menduar lidhur me ndarjen e një vije buxhetore për komuna, ashtu që komunat pastaj direkt ti mbështesin edhe rastet sociale për shërbime, por edhe strehimoret në ato komuna ku janë.

Në lidhje me kompensimi i viktimave të dhunës në familje, ajo theksoi se kjo nuk po ndodh.

Për këtë çështje, ajo shtroi nevojën e një bashkëpunimi më të mirë ndërmjet disa institucioneve, si, policisë dhe gjykatave, për një informim më të mirë për të drejtat e viktimave, të cilat kanë të drejtën e kompensimit, për atë që atyre viktimave u ka ndodhë.

Më tutje, ajo u interesua të dijë se, a keni raportime nga zyrtarët për barazi gjinore që janë të caktuar nëpër komuna.

Nga koordinatori nacional u kuptua se 20% e strategjisë është zbatuar në vitet 2016-2018 dhe se këtë e vlerësoi si shqetësuese.

Sa u përket pozitive të pedagogëve dhe psikologëve, ajo theksoi se është në dijeni se MASHT-i ka ndarë buxhet, por komunat e kanë përdorë për qëllime të tjera.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se është me interes që shkollat mos të mbesin të paktën me një pedagog apo psikolog.

Gjendja aktuale në regjionin e Prizrenit nuk shihet se ka reflektuar me ndryshime për të mirë. Kosova ka shënuar përparim lidhur me Kodin Penal, sa i përket përfshirjes së dhunës në familje si vepër penale, por situata aktuale në vend sa i përket dhunës në familje është shumë shqetësuese dhe se të gjithë aktorët bashkërisht duhet të punojnë për të gjetur mekanizma mbrojtës për të depërtuar në familje, të japim një lloj sensibilizimi në familje dhe pastaj të kemi një fushatë vetdijësuse me viktimat se kanë të drejtë për kompensim.

Albulena Balaj-Halimaj, tha se suksesi është i padiskutueshëm nëse ekziston ndërlidhja institucionale që u përmend në fillim, gjithashtu edhe fushatat vetëdijësuse kanë rolin e vetë në edukimin e mëtutjeshëm të qytetarëve në këtë drejtim.

Naim Qelaj, tha se edhe Kuvendi është pjesë e grupit ndërinstitucional dhe për gjithçka është përgjegjësi e të gjithëve.

Ministria e Arsimit nuk e ka zbatuar strategjinë, ndërsa sa i përket plotësimit të 80 pozitive me pedagogë dhe psikologë, tha se nuk është në dijeni se a ka ndarë buxhet kjo ministri apo jo.

Ai theksoi se ndryshimi i Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, do të jetë i domosdoshëm, duke pasur parasysh se po ndërrohet forma e trajtimit ligjor të kësaj dukurie, sepse tani kjo ka të bëjë me vepër penale.

Sa i përket funksionimit të strehimoreve nuk është faji tek MPMS-ja, por te mënyra se si është planifikuar plotësimi i anës financiare. Ndërsa sa i përket dëmshpërblimit të viktimave të dhunës në familje, Ministria e Drejtësisë e ka të publikuar formularin, ndërsa dëmshpërblimi jepet në fazën finale të përfundimit të procedurës gjyqësore.

Leonora Selmani, tha se te viktimat e krimit Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane e kanë mbajtur një takim, për prezantimin e formularëve për kompensimin e dëmit. Jemi në bashkëpunim edhe me Zyrën e Koordinatorit dhe me institucionet e tjera në mënyrë që si grup ndërministror të arrijmë të zbatojmë këtë strategji dhe ligjin që na obligon të gjithëve.

Adile Shaqiri-Basha, tha se sa i përket zbatimit të strategjisë konkretisht lidhur me shtyllën e mbrojtjes të viktimave të dhunës në familje, çdoherë e kemi përmbushur këtë objektiv.

Shuma që do të mbështeten strehimoret gjatë kësaj periudhe që nuk është më një vit, por periudha maj-dhjetor 2018, është përafërsisht 200 mijë euro.

Në dhjetor të vitit 2017, Kryeministri, me vendim të veçantë ka mbështet me mjete shtesë vetëm strehimoret.

MPMS-ja ka nda një shumë prej 65 mijë euro, për mbështetjen e strehimoreve për muajt janar-mars.

Sa i përket pjesës së riintegrit të viktimave kemi riintegrim por sfidohemi me ri integrimin afatgjatë të viktimave të dhunës në familje.

Lirije Kajtazi, në fund falënderoi përfaqësuesit e institucioneve të ftuara, për të gjitha këto informacione dhe shfaqti bindjen se të gjithë së bashku të punojmë që këto probleme ti tejkalojmë sa me lehtë si shoqëri.

Kryesuesja Lirije Kajtazi, në lidhje me pikën 3 dhe 4 të rendit të ditës, konstatoi se për shkak të mungesës së kuorumit, shtyhen për mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 15:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje